



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 3.2.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Zef Morina Berat Luzha, Hestet Cakolli, Elhëme Hetemi dhe Selvie Halimi.

Munguan : Dragisha Miriç, Ali Lajçi, Ibrahim Selmanaj, Zulfi Merxha .

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MMPH: Naser Bala dhe Nazmi Shkodra.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryesuesi Lulzim Zeneli**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës,

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e Elheme Hetemit : Në diskutimin e saj ajo tha të shtohet se **është bërë fjalë për ndarjen e afateve për projekte të caktuara dhe sa janë ato afate, gjithashtu ajo ka diskutua për koston strategjike zhvillimore**, çka nuk është cekur në procesverbal.

**Kryesuesi Lulzim Zeneli** propozoi të ndryshohet rendi ditës dhe të filloi punën komisioni nga pika e tretë, ku do të shqyrtohen disa pika më të shkurta, si vijon:

1. Sa i përket projektligjit për Tokën Ndërtimore ai i ofroi komisionit propozimin për rekomandim :

## **Projektligji për Tokën Ndërtimore, Privatizimin dhe Dhënien me Qira të Tokës Ndërtimore të kthehet për ripunim propozuesit-Qeverisë së Kosovës.**

**Kryesuesi** e arsyeoi këtë propozim duke pasur parasysh takimet e mbajtura me zyrtarët e USAID-it dhe takimin me zyrtarët e MMPH, ku janë theksuar arsyet për kthimin e projektit në ripunim. Arsyeja kryesore është se ky projekt duhet të ndahet në pjesë të veçantë lidhur me privatizimin dhe kthimin e tokave të cilat janë marr kryesisht në kohën e komunizmit dhe të cilat duhet të kompensohen.

Këtë e konfirmoi edhe **Haxhi Gashi** nga USAID i cili tha se propozimi për kthimin e këtij projekti është koordinuar bashkë me Qeverinë-zyrtarët e MMPH , pasi që bëhet fjalë për çështje madhore të cilat duhet të precizohen më qartë, dhe duhet të formohet një grup profesional. **Berat Luzha** insistoi se këtë punë e bënë Qeveria (kthimi i projektit në ripunim), mirëpo shumica e anëtarëve të komisionit u pajtuan se komisioni duhet të rekomandoi diçka lidhur me një projekt që kalon leximin e parë, sepse si tha **Zef Morina** pas leximit të parë të një projektligji, parlamenti është ai që vendos për atë projekt, me sugjerim nga komisioni funksional, ndaj komisioni sugjeroi :

**të mbetet kjo pikë për shqyrtim për mbledhjen e komisionit të premtën në orën 13,00.**

2. Lidhur me Planin e Punës së Komisionit, kryetari tha se nuk është statike, por ajo do të ndryshoi varësisht prej punëve, ndaj propozoi që të miratohet, çka edhe komisioni **E MIRATOI** atë pa ndonjë shtesë.

3. Gjithashtu komisioni **konfirmoi dy projektligje** (projektligji për Ushqimin dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor) për leximin e dytë, pasi që janë kthyer nga komisionet kryesore me vlerësimet e tyre, ndaj ato mund të nënshkruhen për leximin e dytë.

### **Shqyrtimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes**

**Kryesuesi Lulzim Zeneli** hapi këtë pikë duke sugjeruar që shqyrtimi i projektligjit të filloj nen për nen duke inkorporuar vërejtjet e grupit punues dhe të tjera, si dhe të vazhdoi aty ku ka mbetur në mbledhjen e kaluar.

Në tërë tekstin e projektligjit në vend të AKMM të shkruhet AMMK (Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës).

#### **Preambula**

Të përmirësohet sipas kushtetutës.

#### **Neni 2 pika 5**

Teksti prej shkurtesës “VKE” deri në fund, fshihet.

#### **Amendament i veçant**

Të bëhet lekturimi në fund i ligjit të spastruar, nga administrata e Kuvendit.

**Pika 7 dhe 9 e Nenit 2** riformulohen si vijon:

**7. Autoriteti Republikan është organ qeveritar i autorizuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.**

Në tërë tekstin e projektligjit “Autoriteti kompetent” zëvendësohet me **Autoriteti Republikan**.

**9. Autoriteti Komunal nënkupton organin kompetent në nivel të Komunës.**

Në pikën 12, në fillim riformulohet fjalia si vijon : “leja” është dokument me shkrim i autoriteteve Republikane...” dhe vazhdon : ...që lejon...”. Më tutje fshihet lidhësja “dhe” në reshtin e 4, ndërsa në reshtin e 5 fshihet “integruara”.

**Pika 16**, riformulohet :

**Publiku nënkupton një ose më shumë persona juridik ose fizik, grupet, shoqatat ose organizatat.**

Në pikën 17, në reshtin e 2, “me gjasë do” zëvendësohet me “mund”, ndërsa në reshtin e 4 “azhurnim” zëvendësohet me “përsheptim”.

Te pika 19, në reshtin e parë hiqen dy pikat pas fjalës “përfshijnë”.

Te pika 20, në reshtin e parafundit “sa” bëhet “se”.

**Përkufizimi 21**, fshihet.

**Neni 6, par.1, pika b)**

Pas fjalës “të mira” shtohet “të mundshme”.

**Neni 11, par.2**

Në vend të vitit 2009 të shkruhet **2010**.

**Neni 14, par.1, pika a)**

Fjala “të rrepta” zëvendësohet me “strikte”.

**Neni 21, par.2,**

Në reshtin e parë, numri 500 bëhet **1000**.

**Neni 24** riformulohet,

**Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjet) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.**

Zyrtarët e MMPH kërkuan përmirësimin e titullit të Ligjit në aspektin teknik në versionin serb, të shkruhet : **Nacrt zakon o integrisanom sprečavanju i kontroli zagađivanja sredine.**

Më tutje, gjithashtu të përmirësohet (përshtatet) Neni 1 në versionin serb Nenit 1 të versionit shqip si vijon : **Cilj ovog zakona je integrisano sprečavanje i kontrola zagađivanja sredine koja nastaje kao posledica delatnosti predstavljene u Aneksu 1 ovog zakona, posebno sprečavajući i redukujući otpad emisije u vazduh, vodi i zemlji.**

-**Neni 18**, në reshtin e parë , të hiqet një germë „e“ , e cila dy herë përsëritet.

**Kryetari falenderoi rreth miratimit te verejtjeve p;r kete projektligj.**

Komisioni vendosi të mbaj mbledhje të premtën në orën 13,00 lidhur me projektligjin sipas radhës dhe lidhur me projektligjin për tokën ndërtimore.

Mbledhja përfundoi në orën 14,40.

Kryetari i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**